



**REPUBLIKA E KOSOVES**  
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA  
**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**  
OSNOVNI SUD PRIŠTINA - BASIC COURT OF PRISTINA

---

AD/GJTHPR/02/22

Kryetarja e Gjykatës Themelore në Prishtinë, Albina Shabani Rama, ka shqyrtuar ankesën e ushtruar nga pala L.K, ndaj gjyqtarit A. I, për të vendosur për çështje disiplinore, duke vepruar në mbështetje të nenit 9, paragrafi 6 të Ligjit Nr.06/L-057 Për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe nenit 7, paragrafi 1 dhe 3 të Rregullorës Nr.05/2019 Për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, me datë 17.01.2022 nxjerr këtë:

**V E N D I M**

Refuzohet si e pabazuar ankesa e ushtruar nga L.M ndaj gjyqtarit A.I, për shkak se nuk ka bazë të arsyeshme për inicim të procedurës disiplinore.

**A r s y e t i m**

Pala L.M ka ushtruar ankesë për inicim të procedurës disiplinore ndaj gjyqtarit A.I në Këshillin Gjyqësor të Kosovës, e cila është pranuar në kompetencë nga Autoriteti i Gjykatës Themelore në Prishtinë me datë 30.12.2021. Me datë 11.01.2022 është njoftuar Këshilli Gjyqësor për pranimin e ankesës.

Parashtruesja e ankesës L.M ka paraqitur ankesë ndaj gjyqtarit A.I për shkak të pretendimeve se ka pasur vonesa në procedimin e lëndës PM.nr.283/2019 (2019:191365), dhe lidhur me lirimimin e të pandehurit nga aktakuza gjyqtari është treguar i njëanshëm, dhe sipas parashtrueses së ankesës kanë ekzistuar aktgjykimet e plotfuqishme civile për të paguar detyrimin.

Autoriteti kompetent i Gjykatës Themelore në Prishtinë, pas shqyrtimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës, deklarimit të gjyqtarit dhe pretendimeve të parashtrueses së ankesës, ka vlerësuar se nuk ka dyshim të arsyeshëm për inicim të procedurës disiplinore ndaj gjyqtarit A.I.

Autoriteti i kësaj Gjykate bazuar në faktet e çështjes ka gjetur se, nuk ka baza të arsyeshme për inicimin e hetimeve për shkelje disiplinore në veprimet e gjyqtarit A.I, lidhur me aktgjykimin e marrë, për të cilin pala është ankuar.

Lidhur me pretendimin se ka pasur zvarritje në procedimin e lëndës PM.nr.283/2019, Autoriteti kompetent i kësaj gjykate vlerëson se pretendimet e tilla nuk qëndrojnë pasi gjyqtari i çështjes është caktuar në Departamentin për të Mitur në shtator të vitit 2020, dhe për një kohë ka qenë

gjqytari i vetëm në këtë Departament, dhe ka trajtuar lëndët me prioritet siç janë kërkesat për caktimin e paraburgimit dhe masat tjera për sigurimin e të pandehurve në procedurë penale.

Ndërsa, lidhur me pretendimin e palës ankuese, se gjyqtari A.I ka qenë i njëanshëm në veprimet e tij gjatë procedurës gjyqësore, Autoriteti Kompetent i kësaj gjykate nuk ka gjetur bazë të mjaftueshme për t'i vërtetuar pretendimet e parashtrueses së ankesës dhe po ashtu nuk janë vërtetuar pretendimet për sjellje joadekuate të gjyqtarit respektivisht mos trajtm të barabartë të palëve në procedurë, dhe për këtë vlerëson se nuk është shkelur parimi i pavarësisë dhe paanësisë të përcaktuar me dispozitën e nenit 5, par.2, nën-paragrafi 2.1 dhe 2.7 të Ligjit Nr.06/L-057 Për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

Në lidhje me aktgjykimin e marrë, Autoriteti i kësaj gjykate ju vë në pah se nuk ka të drejtën e komentimit apo ndryshimin e vendimit të marr nga gjykata përkatësisht nga gjyqtari, sepse për mënyrën e vendosjes së çështjes, gjyqtari vepron konform ligjit, në bazë të bindjes së lirë, pa asnjë presion apo ndikim nga kushdo qoftë, bazuar në provat/shkresat e lëndës, të thënat e palëve në procedurë si dhe legjislacionit në fuqi.

Për aplikimin e gabuar të së drejtës materiale apo procedurale nga ana e gjyqtarit/ve gjatë punës së tyre, mund të jetë shkak për ushtrimin mjeteve të rregullta apo të jashtëzakonshme në gjykatat e instancave më të larta nga pala e pakënaqur por nuk mund të konsiderohet shkelje disiplinore.

Andaj, Autoriteti Kompetent i Gjykatës Themelore në Prishtinë lidhur me ankesën e ushtruar, bazuar në të dhënat e përshkruara më lartë, vlerësoj se nuk ka bazë të arsyeshme të besoj se gjyqtari ka kryer shkelje disiplinore, për t'i parashtruar Këshillit Gjyqësor të Kosovës kërkesë për fillimin e hetimeve disiplinore.

Nga të cekurat më lartë, në bazë të nënit 7, paragrafi 3, të rregullorës Nr.05/2019, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

## GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

AD/GJTHPR/02/22, me datë 17.01.2022

Albina Shabani Rama

---

Kryetare e Gjykatës Themelore në Prishtinë